

## KOMUNA E GJAKOVËS 2017: PROBLEMET KRYESORE DHE TRENDET BUXHETORE

### Hyrje

Gjakova udhëhiqet nga Mimoza Kusari-Lila. Në kohën e nisjes së mandatit të kryetares, ajo ka qenë pjesë e partisë politike Aleanca për Kosovën e Re (AKR). Pas tri viteve ka deklaruar tërheqjen nga kjo parti, duke formuar një subjekt të ri politik “Alternativa për Kosovën”. Në zgjedhjet e kaluara lokale, Kusari-Lila në raundin e parë ka pasur 20,160 vota (apo 44%), ndaj Pal Lekaj nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, i cili në raundin e parë kishte marrë gjithsej 16,376 vota (36%). Në balotazh, Kusari-Lila ka fituar 25,183 vota (52%) ndërsa Lekaj ka marrë 22,890 vota apo 47%.<sup>1</sup>

Hulumtimet tregojnë se qytetarët e Kosovës kanë njohuri të mjaftueshme mbi ndarjen e kompetencave në mes të pushtetit qendror dhe lokal dhe kryesisht i dinjë mundësitë buxhetore e ligjore që ka një komunë.<sup>2</sup> Mbi 93% e qytetarëve të Gjakovës konsiderojnë se komuna mund t'i zgjidhë problemet me të cilat ballafaqohen ata.<sup>3</sup> Dy vite pas nisjes së mandatit të kryetares Kusari-Lila, afro 80% e qytetarëve janë shprehur të kënaqur me punën e saj, përderisa 66% e qytetarëve kanë konsideruar se fondet publike në komunë menaxhohen siç duhet.<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Rezultatet për Kryetarë Komune 2013. Burimi: <http://bit.ly/1d30foS> (Hapur më 18 qershor 2017) Rezultatet për Balotazh. Burim: <http://bit.ly/2szzr1OU> (Qasur më 18.06.2017)

<sup>2</sup> Instituti GAP, Adresimi i Përgjegjësisë: Njohuritë e qytetarëve me kompetencat e komunave. Maj 2017. Burimi: <http://bit.ly/2os7GPU> (Qasur më 18.06.2017)

<sup>3</sup> Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 37. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr>

<sup>4</sup> Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 91 & 92. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr>

Në prag të zgjedhjeve lokale 2013, Instituti GAP kishte identifikuar problemet kryesore të Komunës së Gjakovës. Ndër problemet më madhore kishin dalë të jenë: mungesa e ujit të pijes në rajonin e quajtur Reka e Keqe, problemet me infrastrukturë në çarshinë e vjetër, mbeturinat në lumin Krena, mungesa e fushave rekreative dhe sportive si dhe prezenca në shumë vendbanime e shitëseve ambulante.<sup>5</sup>

## **Problemet aktuale të Komunës së Gjakovës**

### **Menaxhimi i mbeturinave**

Komuna e Gjakovës ballafaqohet me një gjendje relativisht të rëndë të menaxhimit të mbeturinave. Grumbuj mbeturinash mund të vërehen në çdo anë të qytetit. Gjithashtu, ka mungesë të theksuar të kontejnerëve të mbeturinave. Për ilustrim, e gjithë zona e qendrës dhe çarshisë së vjetër kryesisht nuk ka kontejner të vetëm të mbeturinave ku qytetaret mund të hedhin mbeturinat.<sup>6</sup>

### **Ujërat e zeza**

Përkundër faktit që ka filluar implementimi i projektit për trajtimin e ujërave të zeza, ujërat e zeza vazhdojnë të jenë në mesin e problemeve të mëdha të kësaj komune. Ky projekt është vetëm për një pjesë të qytetit, pra atë pjesë që është afër lumit Krena (kryesisht ana perëndimore e qytetit) dhe nuk përfshin rreth 60% tjetër të qytetit. Probleme me ujërat e zeza ka në shumicën e fshatrave të Komunës së Gjakovës. Gjithashtu probleme me ujërat e zeza ka edhe në qytet në disa lagje ku ndërtimet janë bërë në shpejtësi dhe kanë dëmtuar rrjetin e kanalizimit dhe gypat e ujit.

### **Ndotja akustike**

Kjo problematikë është më e evidente gjatë sezonit të verës, kur edhe rritet numri i dasmave dhe ahengjeve, dhe rritet dukshëm aktiviteti i kafiterive dhe klubeve të natës. Zëri i lartë që vjen sidomos nga kafiteritë dhe klubet e natës që funksionojnë në qiell të hapur mund të dëgjohet pothuajse në të gjithë qytetin, duke shkaktuar pakënaqësi tek shumë persona. Banorët e Gjakovës kanë dorëzuar disa herë ankesa në komunë për të adresuar këtë problematikë, por udhëheqësit e komunës nuk kanë ndërmarr ndonjë hap serioz në zgjidhjen e këtij problemi.

---

<sup>5</sup> Instituti GAP. Problemet Kryesore dhe trendet buxhetore të Komunës së Gjakovës 2013. Burim: <http://bit.ly/2sUg64Y> (Qasur me 18.05.2017)

<sup>6</sup> Problemet nëpër komuna janë listuar bazuar në intervista të drejtpërdrejta me përfaqësues komunal, të partive politike, shoqërisë civile, mediave dhe njohëseve të qeverisjes lokale.

## **Transporti urban**

Në Komunën e Gjakovës ka mungesë të theksuar të linjave urbane të transportit. Ekziston vetëm një linjë e transportit urban. Mungojnë linja që lidhin zonat rurale me qytetin, gjë e cila kufizon lëvizjen e qytetareve si për plotësimin e nevojave ashtu edhe për qasjen në vend të punës ose në shërbime arsimore dhe ato shëndetësore.

## **Fushat që kërkojnë vëmendjen e komunës**

### **Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në fshatra**

Pjesa më e madhe e fshatrave të komunës së Gjakovës janë jashtë sistemit të ndriçimit publik. Kjo konsiderohet të jetë njeri nga faktorët e përhapjes së dukurisë së vjedhjes së bagëtive gjatë orëve të natës. Komuna duhet t'i kushtojë vëmendje kësaj çështjeje dhe të planifikojë buxhet në këtë drejtim.

### **Rregullimi i urës së Kramovikut**

Kjo urë lidh pjesën e Klinës me Gjakovën dhe shfrytëzohet si destinacioni kryesor i hyrjes në Gjakovë edhe nga drejtimi i Prishtinës dhe i Pejës. Ura është dëmtuar në verën e vitit 2013 nga të reshurat dhe vërshimet. Ura ka pasur disa ndërhyrje të vogla për t'u sanuar, por rreziku i shembjes së saj nuk është evituar. Komuna duhet të bëjë një studim të qëndrueshmërisë së urës dhe duhet të fillojë vendosjen e shtyllave shtesë me qëllim të shmangies së ndonjë tragjedie eventuale.

## **Trendet buxhetore në Komunën e Gjakovës (2017)**

Komuna e Gjakovës në vitin 2017 ka planifikuar 21.2 milion euro buxhet.<sup>7</sup> Përveç të hyrave të rregullta, nga viti i kaluar janë bartur të hyra vetanake rreth 1.3 milionë euro, ndërsa në vitin 2013 ishin bartur rreth 335 mijë euro. Krahasuar me vitin 2013, Komuna e Gjakovës ka pasur një rritje afro 2 milion euro të buxhetit (12%). Rritja e buxhetit ka ardhur kryesisht nga rritja e grantit të përgjithshëm qeveritar dhe një rritje e lehtë në planifikimin e të hyrave vetanake.


Rritja e buxhetit krahasuar 2017 me kohën e zgjedhjeve të fundit (2013) është bërë në kategorinë e pagave, por ka pasur rënie të buxhetit në investime kapitale. Kësisoj për paga në 2013 janë ndarë rreth 10 milionë euro, përderisa në 2017 ky buxhet është për rreth 2.8 milionë euro me i

---

<sup>7</sup> Shih për më shumë platformën buxhetore të Institutit GAP në <http://bit.ly/2rMELbD>


lartë, ndërsa në kategorinë e investimeve kapitale në 2013 janë ndarë rreth 6 milionë euro ndërsa në 2017 janë ndarë 5.4 milionë euro, apo rreth 576 mijë euro me pak se krahasuar me 2013.

**Figura nr.1:** Trendët buxhetore të Gjakovës 2013-2017




Në bazë të grafikorit shohim se Komuna e Gjakovës vazhdimisht ka pasur një dominim të shpenzimeve në paga dhe trendi ka shkuar në rritje, përderisa investimet kapitale kanë pasur lëvizje të ndryshme, kryesisht gjatë viteve të fundit është shënuar rënie.

**Figura nr.2:** Përqindja e investimeve kapitale dhe plagëve për disa komuna - 2017



Sa i përket të hyrave vetanake të komunës gjatë vitit 2016 Gjakova ka mbledhur 3.2 milionë euro. Krahasuar me vitin 2013, të hyrat e mbledhura vetanake janë për rreth 834 mijë euro (35%) më të larta.

**Figura nr.3:** Të hyrat vetanake të komunës së Gjakovës





## Rekomandimet

Duke u bazuar në problemet kryesore, fushat të cilat kërkojnë vëmendjen e Komunës dhe trendët buxhetore, Instituti GAP rekomandon që qeverisja e komunës e dalë nga zgjedhjet lokale të 2017 të ndërmerr këto veprime:

- Komuna e Gjakovës duhet të vendos në të gjithë qytetin shporta për hedhjen e mbeturinave të imta dhe njerëzi duhet të shikojnë mundësinë e vendosjes së kontejnerëve nëntokësor në të gjitha zonat.
- Komuna e Gjakovës duhet të ndërmarr masa në zvogëlimin e zhurmës në qendrat urbane.
- Komuna e Gjakovës duhet të shtrijë rrjetin e ndriçimit publik edhe në fshatra, veçmas në rajonin e Rekes së Keqe.
- Komuna duhet të bëjë një studim të qëndrueshmërisë së urës në Kramovik me qëllim të shmangies eventuale të ndonjë tragjedie nga shembja eventuale e saj.

INSTITUTI GAP  
GAP INSTITUTE



Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

**Ky projekt mbështetet nga:**



**National Endowment  
for Democracy**

*Supporting freedom around the world*